

ENTROPY new Album / Release Sept. 2016
EDA ZARI feat. IBRAHIM MAALOUF
ENJA RECORDS Germany



Parafjalë

Udhëtim në bizant

"[...] Prandaj lundrova detrat dhe erdha
Në qytetin e shenjtë Bizant."
Duke lundruar për në Bizant
nga William Butler Yeats

nga Sokol Çunga
arkivist, paleograf
Arkivi Qendror Shtetëror

Në përfytyrimin e njeriut modern perëndimor, Bizanti vazhdon të mbetet një periudhë historike ekzotike, misterioze dhe e errët, e një të kaluar shumë të largët. Termi "bizantin", në zhargonin e përditshëm, përkufizon një njeri apo sjellje dredharake, të paligjshme, imorale. Këtij paragjykimi i kundërvihen qetësisht monumentet e mbetura më këmbë kudo në zonat ku ka qenë shtrirë Perandoria Bizantine, rrënojat e dukshme apo ato që presin të zbulohen, dokumentet e ndodhura në arkivat historikë të Evropës, arkitektura, letërsia, arti pamor dhe, ajo më pak e njohura, muzika.

Ndonëse muzika bizantine ka luajtur një rol të rëndësishëm në muzikën perëndimore, ajo ka mbetur një *terra incognita* për perëndimin, si për studiuesit dhe muzikantët (përjashtoj një komunitet shumë të vogël), ashtu dhe për dëgjuesin, në përgjithësi. Shkaqet për këtë mosnjohje janë komplekse dhe të dyanshme. Nga njëra anë qëndrojnë ndryshimet kulturore dhe gjuhësore mes Lindjes dhe Perëndimit, distanca që u vendos mes dy poleve kulturore pas skizmës së Kishave (viti 1054), interesi i ngushtë për të studiuar vetëm pikat ku dy qytetërimet takohen me njëri-tjetrin, si dhe fakti që studiuesit perëndimorë e patën drejtuar vëmendjen tek dorëshkrimet e shek. X-XIII, duke e konsideruar muzikën "neo-bizantine", jo pa përçmim, si të padallueshme nga muzika osmane. Pas rënies së Konstandinopojës dhe shkatërrimit të Perandorisë, muzika bizantine u zhvillua, kryesisht, brenda kontekstit kishtar, nuk u bë muzikë oborresh (e kundërta e muzikës klasike në perëndim), mbeti e pa lidhur me ndonjë strukturë shtetërore, e njohur vetëm për ata që kapërcenin pragun e kishës.

Nga ana tjetër, komunitetet lokale që e përdorin muzikën bizantine, deri vonë nuk e kanë promovuar studimin e saj, duke sjellë, si pasojë, mungesën e interesit nga perëndimi. Interpretuesit dhe muzikologët e muzikës bizantine nuk e kanë pasur të

lehtë të krijojnë një dialog konstruktiv me publikun dhe studiuesit perëndimorë, sa për shkaqe të brendshme (arsye të thjeshta praktike, apo krenaria e ruajtjes së një tradite qindravjeçare), aq edhe të ndodhur përballë një debati në kufijtë e imperializmit kulturor, të cilin e kanë mbajtur ndezur studiuesit perëndimorë.

Ndërkaq, qytetërimi perëndimor nuk ka mbetur pa u ndikuar nga modele më të vjetra apo të panjohura muzikore. Interesi i mendimtarëve perëndimorë të shek. XIX-XX (Friedrich Nietzsche, Herman Hesse, etj.) për kulturën e Lindjes së Largët nuk la pa ndikuar brezat e pas Luftës II Botërore. Në kërkim të udhëve të reja, për të gjetur lumturi dhe ndriçim shpirtëror, duke mos përfillur krishterimin, një pjesë e qytetërimit perëndimor gjeti zgjidhje tek kultura dhe spiritualiteti lindor aziatik. Filozofia, letërsia dhe spiritualiteti zen dhe budist u kthyen në mënyrë jetese për shumë perëndimorë, u bënë, po ashtu, lajtmotivi i lëvizjeve kulturore-shoqërore si Beat Generation dhe Hippie. Teksa u huazua si muzikë rituale-spirituale, muzikës budiste iu hap vend lehtësisht brenda muzikës moderne, duke i dhënë mundësi të zhvillohej brenda rrymave muzikore Rock’N’Roll, Pop dhe, sidomos, asaj New-Age. Po kaq e pranishme ishte edhe në kinematografinë popullore amerikane. Efekti komercial, vetvetiu, solli njohjen e saj të gjerë nga njeriu modern i shek. XX-XXI.

Shijet perëndimore për ekzotiken dhe të vjetrën nuk u kufizuan vetëm me muzikën e Lindjes aziatike. Gjatë gjysmës së e dytë të shek. XX u risoll në vëmendje, mes të tjerash, edhe muzika gregoriane. Veç përdorimit të saj në adhurim, apo promovimit që iu bë nga kore murgjish bashkëkohorë, muzika gregoriane u bë e kërkuar edhe në mjedise diametralisht të kundërta me misionin e saj fillestar, duke u huazuar nga rryma muzikore si Rock’N’Roll, Pop, Techno, New-Age, Power/Thrash Metal, Black Metal, etj. Është mëse e kuptueshme se pas një përfshirjeje të tillë, orientimi për tek muzika gregoriane mbetet çështje shijeje, jo informacioni.

Në territorin e Shqipërisë së sotshme, muzika bizantine është përhapur bashkë me përhapjen e krishterimit. Zhvillimi i saj ndodhi natyrshëm, si edhe në çdo vis tjetër ku vepronte Kisha e Lindjes. Ndërprerja e vetme e madhe ndodhi mes viteve 1967-1991, kur shteti ateist shqiptar ndaloi me ligj çdo manifestim fetar në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Dëmi ishte i madh, por vetëdija nuk humbi. Sot, të gjurmosh traditën e muzikës bizantine në Shqipëri është si të gërvishtësh një mur të lyer me shumë bojëra, për të nxjerrë në dritë afreskun e fshehur nga koha dhe njerëzit.

Muzika bizantine – njësi kulturore e bizantit

Njësia shtetërore, politike, ushtarake, ekonomike dhe kulturore, e cila njihet sot si “Perandori Bizantine”, nga vendasit quhej Perandori Romake (ose Perandori e Romës së Lindjes). Zyrtarisht u themelua më 324 pas Krishtit, duke pasur si qendër

administrative kryeqytetin e themeluar prej Konstandinit të Madh dhe të emërtuar sipas tij: Konstandinopojë.

Faktet tregojnë se në bizant ka qenë zhvilluar gjerësisht muzika shekullare, e cila ishte vokale dhe instrumentale. Fatkeqësisht, tradita e kësaj muzike nuk ka mbërritur në ditët tona dhe informacionet për të janë të pakta dhe fragmentare. Ajo që ka mbijetuar është muzika që këndohej në kishë.

Muzika bizantine është muzikë vokale monofonike liturgjike. Është përdorur gjerësisht në adhurim nga Kisha e krishterë e Lindjes, por, ndryshe nga Perandoria, nuk e ndali zhvillimin e vet më 1453. Prejardhja e muzikës bizantine është e përbërë. Rrënjët më të hershme mund të gjenden tek muzika adhuruese e judenjve, tek muzika dhe poezia klasike greke, por edhe tek muzika siriane. Përpara themelimit të Konstandinopojës, u zhvillua në qytetet e para të krishtera të Aleksandrisë, Antiokisë dhe Efesit. Dorëshkrimet më të vjetra me shenjat muzikore bizantine, që quhen *shenja ekfonetike*, i hasim që në shek. IX (pas Krishtit), kurse dorëshkrimet e mirëfillta muzikore, të pajisura me *neuma*, datojnë që prej shek. X.

Kisha e hershme e periudhës paleo-kristiane praktikonte këndimin (psaljen) nga i gjithë grupi i besimtarëve që ishin të pranishëm në adhurim. Në shek IV, meqenëse jo të gjithë besimtarët arrinin të mbanin mend çdo melodi që këndohej, por edhe për arsye estetike, përgjegjësinë e këndimit e merr një grup besimtarësh të talentuar dhe të stërvitur me artin e psaljes, *psaltët*. Detyra e psaltëve është të këndojnë gjatë shërbesave fetare në kishë, me kujdes dhe përpulsi. Tradicionalisht, psalti apo kori i psaltëve janë meshkuj. Kjo, pasi psaltët konsiderohen kler i ulët, dhe grada klerikale nuk u jepet femrave. Sidoqoftë, në kohët e sotshme ky rregull nuk është absolut. Femrat apo fëmijët mund të psalin edhe pa marrë uratën e posaçme, vetëm apo në kor, gjatë adhurimit apo jashtë ceremonive fetare.

Sipas mendimit teologjik dhe mistik të Kishës Ortodokse, muzika bizantine u transmetua nga engjëjt tek njerëzit në vitet e para të krishterimit, në kohën kur besimtarët luteshin dhe këndonin së bashku me koret engjëjllore. Ky koncept, i cili dominoi deri në rënien e Bizantit, solli tre dukuri tek muzika bizantine: 1. bëri që Kisha të mbante qëndrim konservativ ndaj zhvillimit të pakontrolluar të kompozimeve muzikore; 2. sanksionoi tradita melodike dhe një pjesë të himneve; 3. frymëzoi, për një farë kohe, anonimitetin e kompozitorit/autorit. Me rënien e Bizantit dhe ardhjen në fuqi të Perandorisë Osmane, e cila, në Azinë e Vogël dhe në Ballkan u vendos në po ato territore që dikur ishin pjesë e Bizantit, muzika bizantine vijoi të ruhej dhe të kultivohej nga të krishterët ortodoksë, një popullsi multi-etnike që jetonte në territorin e osmanëve. Me zhvillimin e kombeve-shtete, në shek. XIX-XX, nënshtetasit e krishterë të shteteve laike vijuan ta ruanin muzikën bizantine përmes adhurimit, dhe sot muzika është një nga elementët më të përveçëm në adhurimin ortodoks.

Kisha Ortodokse që vepron në territorin e Shqipërisë së sotshme ka qenë ndodhur, në pjesën më të madhe të kohës, nën varësinë e Patriarkanës së

Konstandinopojës, prej së cilës ka marrë dhe traditën liturgjike. Gjuha zyrtare e shërbesave ka qenë greqishtja, deri në kohën e formimit të identitetit kombëtar shqiptar. Pasi u shpall autoqefale (e pavarur nga Patriarkana), Kisha Ortodokse e Shqipërisë vijoi të ruante traditën konstandinopolitane të shërbesave, ruajti muzikën bizantine në adhurim, por ndërroi gjuhën e shërbesave, nga greqisht, në shqip. Më 1908, kleriku ortodoks Theofan S. Noli, përktheu dhe botoi për ortodoksët shqiptarë të Bostonit, në Massachusetts, ShBA, librin e parë me shërbesa fetare në shqip.

Pas ndalimit të fesë më 1967, KOASH filloi veprimtarinë e saj më 1991, duke ringjallur, njëkohësisht, edhe përdorimin e muzikës bizantine. Sot në Shqipëri funksionojnë disa kore të muzikës bizantine, të cilët veprojnë në qytete të ndryshme të vendit. Në vitin 2013 në Tiranë u çel Shkolla e Muzikës Bizantine “Joan Kukuzeli”, pranë së cilës funksionon dhe kori me të njëjtën emër, pjesë e këtij albumi.



eda zari

www.eda-zari.com